



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 mars 2020
Nr. ref.:RK1521/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/19

Parashtrues

Muharrem Mehmeti

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
ARJ-UZVP.nr.62/2018, të 5 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Muharrem Mehmeti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr.62/2018] e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 5 dhjetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe neni 7 i Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 prill 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 prill 2019, Kryetarja caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 18 prill 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 6 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë, një Urgjencë për përshpejtim të rastit të tij para Gjykatës.
9. Më 23 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës sërish e dorëzoi në Gjykatë, edhe një Urgjencë për përshpejtimin e rastit të tij para Gjykatës.
10. Më 22 janar 2020, parashtruesi i kërkesës sërish e dorëzoi në Gjykatë, për të tretën herë, Urgjencën për përshpejtimin e rastit të tij para Gjykatës.
11. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës vërehet se Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS) përmes Vendimit të datës 9 nëntor 2015, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit, për njohjen e të drejtës në pension kontibutpagues të moshës.
13. Më 8 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) duke kërkuar që të anulohet Vendimi i MPMS-së i 9 nëntorit 2015, duke pretenduar se i plotëson kushtet për njohjen e pensionit kontibutpagues të moshës, me faktin se kishte qenë punëtor i ndërmarrjes Trepça prej vitit 1982 deri më 1990, kur edhe ishte larguar nga puna.
14. Më 4 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.2080/15/b] refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin e MPMS-së të 9 nëntorit 2015. Gjykata Themelore kishte arsyetuar në Aktgjykimin e saj se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për të përfitur të drejtën në pension kontibutpagues të moshës. Më tutje në këtë Aktgjykim theksohet se *“Duke analizuar kriterin ligjor në nenin 8 pika 1.3 Gjykata vëren se në mënyrë që autoriteti publik të vendos për të drejtën e pensionit kontributdhënës pala duhet të ofrojë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr 26/83) i 1.01.1999. Nga shkresat e lëndës Gjykata gjen, siç është konstatuar edhe në vendimin e organit të paditur se pala paditëse ka deponuar dëshmi (librezë e punës) vetëm për kontributet në kohëzgjatje prej 8 viteve, 4 muaj dhe 13 ditëve. Andaj Gjykata gjen se vendimi i organit të paditur në këtë çështje administrative është ligjërisht i drejtë”*.
15. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimet se i njëjti ishte marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 18 korrik 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.57/2018] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [A.nr.2080/15/b] e Gjykatës Themelore, të 4 tetorit 2017. Gjykata e Apelit e arsyetoi pabazueshmërinë e ankesës mbi faktin se Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në mënyrë të drejtë dhe pa shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Më tutje, u konsiderua se Gjykata Themelore kishte administruar provat dhe faktet në mënyrë të drejtë dhe në tërësi, si dhe kishte zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të duhur.
17. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr.62/2018] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj më tej ka konsideruar se “Qëndrimin juridik të gjykatave të instancës së ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimet e atakuara nuk janë përfshirë me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendon paditësi në kërkesë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të rregullt] të KEDNJ dhe neni 7 i DUDNJ.
20. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Vendimeve të gjykatave të rregullta, pretendon se “vendimet në fjalë nuk janë mbështetur në rekomandimin ex officio nr.235/18 i lëshuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar organeve ekzekutive dhe Raporti i Drejtorit të përgjithshëm nga Zyra Ndërkombëtare e Punës GB.253/17/17 Gjenevë 1992”.
21. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: “Kërkesa ime është llogaritja e viteve 88/99 të humbura nga regjimi serb pa dëshirën time. Kërkoj që të llogariten ato vite të humbura siq janë njohur arsimit dhe shëndetësisë.”

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 04/L-212 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

[...]

[Neni 8]

[Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës]

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:
 - 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;
 - 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;
 - 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83.
2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjera, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse.

3. Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj.

4. Përjashtimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.

5. Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetetpërkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale.

6. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

25. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti

publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr.62/2018] e 5 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

26. Megjithatë, përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

27. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së si dhe me nenin 7 i DUDNJ-së.
28. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në substancë, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij gjykatat e rregullta nuk e kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke ia refuzuar si të pabazuar kërkesën parashtruesit për njohjen e pensionit kontibutpagues të moshës .
29. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e drejtë të fakteve, të bërë nga Gjykata Supreme dhe ato të instancave më të ulëta.
30. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, rastin e Gjykatës, KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
31. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

32. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
33. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
34. Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës arsyetoi se Gjykata e Apelit, me të drejtë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit, pasi që parashtruesi i kërkesës në kuptim të nenit 8 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk kishte ofruar dëshmi bindëse për pagesën e kontributeve nga përvoja e punës ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit të lartpërmendur.
35. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj kishte theksuar si në vijim:
- “kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës , është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi..*
- Nga provat e administruara rezulton se paditësi në kuptim të nenit 8 të Ligjit 04/L-131 nuk ka ofruar dëshmi bindëse për pagesën e kontributeve nga stazhi i punës, sipas Ligjit të cekur më lartë.”*
36. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
37. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës,

parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33)

38. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
39. Si përfundim, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e papabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Arta Rama-Hajrizi